



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr.49, Datë 02.04.2024

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL SH.A. PËR PËRCAKTIMIN E
ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR KATEGORINË E
KLIENTËVE “FURRA BUKE DHE/OSE PRODHIM MIELLI TE LIDHURA NË
NIVELIN E TENSIONIT 0.4 KV”**

Në mbështetje të neneve 16, 83 dhe 85 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 15, 19, 21 dhe 22 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.06.2022 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; si dhe “Metodologjisë së Përcaktimit të Çmimeve për Shitjen e Energjisë Elektrike me Pakicë tek Klientët Fundorë që Furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a.” miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.189, datë 23.11.2017; Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 02.04.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 793/1 prot., datë 29.03.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së Furnizuesit të Shërbimit Universal sh.a. për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për kategorinë e klientëve “furra buke dhe/ose prodhim mielli”,

Konstatoi se:

- Shoqëria FSHU sh.a. me shkresën nr. 1583 prot., datë 19.03.2024, protokolluar në ERE me nr.793 prot., datë 20.03.2024, ka përcjellë në ERE kërkesën për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për kategorinë e klientëve “Furra buke dhe/ose prodhim mielli” të lidhur në nivelin e tensionit 0.4 kV.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 366, datë 15.12.2023 vendosi të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.04.2022, deri në miratimin e një vendimi mbështetur në aplikimin e shoqërisë FSHU sh.a., për vitin 2024, për çmimet me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal në përputhje me kërkesat

e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Sipas vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.04.2022, përcaktohet se çmimi i shitjes së energjisë elektrike për subjektet “Furra buke dhe/ose prodhim mielli ne 0.4 kV” do të jete 7.6 leke/kWh dhe çmimi i energjise aktive ne pik do të jete 8.74 leke/kWh.

- Vlerësojmë se shoqëria FSHU sh.a. legjitimohet si palë në kërkesën e paraqitur, si subjekt i licencuar nga ERE në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike dhe i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik si furnizues i shërbimit universal sipas vendimin e bordit të ERE nr. 112, datë 08.07.2016 “Për përcaktimin e të licencuarit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike dhe përcaktimin e kushteve për ushtrimin e detyrimit të shërbimit universal”.
- Rezulton se faturimi i energjisë elektrike për subjektet që ushtrojnë veprimtarinë “Furra Buke dhe/ose Prodhim Mielli” ka patur një sërë problematikash për të cilat ka vijuar të ketë korrespondenca dhe takime të zhvilluara midis FSHU sh.a., Shoqatës së Prodhuesve të Bukës, Pasticerisë dhe Brumrave dhe ERE si dhe gjithashtu është zhvilluar një seancë dëgjimore me përfaqësuesit e shoqatës dhe shoqërisë FSHU sh.a..
- Gjithashtu, shoqëria FSHU sh.a., ka përcjellë një kërkesë për rishikim të këtij çmimi gjatë vitit 2023, për të cilën Bordi i ERE-s me vendimin nr. 226, datë 14.07.2023, ka vendosur mospranimin e kërkesës në kushtet kur asnjë nga palët nuk ka përcjellë në ERE propozimet e tyre për këtë çështje siç lënë detyrë gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar në ERE më datë 13.06.2023.
- Sikurse cituar me sipër shoqëria FSHU sh.a., me shkresën nr. 1583 prot., datë 19.03.2024, ka paraqitur kërkesën për përcaktim të çmimit të shitjes së energjisë elektrike për subjektet “Furra buke dhe/ose prodhim mielli” të lidhura në nivelin e tensionit 0.4 kV, duke propozuar një kategorizim të ri të këtyre subjekteve duke u përshtatur dhe me zhvillimet e këtij sektori ndër vite.
- Në këtë kërkesë FSHU sh.a. i ka propozuar ERE-s përcaktimin e çmimit të energjisë elektrike për aktivitetin “Furrë Buke, dhe /ose prodhim mielli” në nivelin e tensionit 0.4 kV në kategori si me poshtë vijon:
 - **Kategoria I** – Vetëm Furra Buke/Prodhim mielli – Çmimi i furnizimit me energji elektrike **7.6 lekë/kWh**;
 - **Kategoria II** – Furrë buke, produkte miell shoqëruese, pastiçeri– Çmimi i furnizimit me energji elektrike **9.5 lek/kWh**;
 - **Kategoria III** – Furrë buke, produkte miell shoqëruese, pastiçeri, shërbim Kafë (ekspres) – Çmimi i furnizimit me energji elektrike **12 lek/kWh**.
- Me qëllim shqyrtimin më tej të kësaj kërkesë të shoqërisë FSHU sh.a., si dhe në zbatim të nenit 5 të “Metodologjisë së Përcaktimit të Çmimeve për Shitjen e Energjisë Elektrike me

Pakicë tek Klientët Fundorë që Furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)'' miratur me vendimin e bordit të ERE-s nr. 189, datë 23.11.2017, shoqëria FSHU duhet të paraqesë dokumentacionin sa më poshtë vijon:

- Depozitimin pranë ERE të një liste të të ardhurave dhe shpenzimeve aktuale të FSHU sh.a për 12 muajt e fundit.
 - Informacion të detajuar mbi alokimin e kostove reale për 12 muajt e fundit për secilën kategori klientësh, në mënyre që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe i mbështetur në të dhëna konkrete dhe reale.
 - Parashikimin e të ardhurave të kërkuara të FSHU për periudhën rregullatore, objekt i shqyrtimit.
 - Efektet e pritshme në të ardhurat e shoqërisë nga tarifat dhe çmimet e propozuara për kategoritë e reja të konsumit.
 - Çdo ndryshim në strukturën e tarifave dhe çmimeve që pritet të rezultojnë nga propozimi i paraqitur.
 - Shpërndarjen e kërkuar për strukturën e propozuar të çmimeve për të përfituar të ardhurat e kërkuara për çdo kategori çmimesh.
 - Çdo informacion tjetër të nevojshëm për të argumentuar ndryshimet që mund të rezultojnë në strukturën e tarifave dhe çmimeve.
- Gjithashtu vlerësohet se përgjatë vitit 2024, FSHU sh.a. të kryejë studime në lidhje me furrat e bukës për një rikategorizim sa më të drejtë të tyre.
 - Rezulton se jemi në kushtet ku kërkesa është në mbështetje të pikave 1 dhe 2 të nenit 21 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, ku parashikohet se: *“I licencuari që kërkon përcaktimin e tarifave dhe çmimeve të shërbimeve të energjisë elektrike dhe të gazit natyror për vitin pasardhës jo më vonë se data 1 Shtator të vitit aktual duhet të paraqesë në ERE një kërkesë me shkrim, të shoqëruar me të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar sipas kësaj rregullore dhe metodologjive përkatëse; si dhe mbas shqyrtimit paraprak dhe në kushtet kur aplikimi i plotëson kryesisht kërkesat e shprehura në pikat 1-4 të nenit 22 të po kësaj rregulloreje, ERE mund të marrë vendimin për fillimin e procedurave për shqyrtimit të aplikimit të një të licencuari”*.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për kategorinë e klientëve “furra buke dhe/ose prodhim mielli” të lidhura ne nivelin e tensionit 0.4 kV si vijon:

Kategoria I – Vetëm Furra Buke/Prodhim mielli – Çmimi i furnizimit me energji elektrike **7.6 lekë/kWh**;

Kategoria II – Furrë buke, produkte miell shoqëruese, pastiçeri– Çmimi i furnizimit me energji elektrike **9.5 lek/kWh**;

Kategoria III – Furrë buke, produkte miell shoqëruese, pastiçeri, shërbim Kafe (ekspres) – Çmimi i furnizimit me energji elektrike **12 lek/kWh**.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojnë shoqërinë FSHU sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË

Erjola SADUSHI